Altin Kocaqi

DOKUMENTE HISTORIKO-GJUHËSORE

Vëndi i shqipes ndër gjuhët evropiane

"MARIN BARLETI" 2013



GJUHËSIA "BORGJEZE" EUROPIANE

"Nxënësi i Franc Boppit, August Pott, e cilëson shqipen si gjuhë *Iliropellazge që nuk ka lidhje me greqishten e latinishten, por është gjuhë paraindoevropiane* "

CarloTagliavini, Albania, Lingua. EnciklopediaI Italiana.vol 2 (1929) 123

"Demetrio Camarda vërtetoi me anë të mbetjeve origjinale të gjuhës së Homerit, se shqipja është gjuhë parahomeriane ose siç e quajti ai "Gjuha e Perëndive"
Konstandin Paparigopulos, Paulos Karolidhu. "Isagogji is tin istorian tu elliniku ethnus",botimi i tetë, vol I, f . mz.
"Një interes të veçantë për gjuhësinë shqiptare paraqet çështja a ka ndonjë lidhje midis gjuhëve ose gjuhës së substrakteve paragreke të Greqisë së vjetër dhe gjuhës shqipe, ose mbeturinave të atyre substrakteve në këtë gjuhë. Ky problem lidhet me emrin e Pellazgëve e të pellazgjishtes"
Eqerem Çabej. "Hyrje në historinë e gjuhës shqipe I", f 90 sh b "Çabej", Tiranë 2008

LUFTA SHQIPTARE KUNDËR GJUHËSIS BORGJEZE

"Edhe mua m'u kujtua viti 1952, kur Dhimitër Shuteriqi e kishte quajtur "antipatriotike" veprimtarinë shkencore të Eqrem Çabejt. Po kështu, edhe S.Pollo, duke bërë aluzion se studiues si Çabej i kishte vlerësuar si njerëz "tek të cilët nuk ekziston asnjë thërrimë patriotizmi" si njerëz që "vazhdojnë të mohojnë origjinalitetin e gjuhës sonë", si njerëz që "përulen verbërisht përpara të ashtuquajturave autoritete të gjuhësisë borgjeze të

Perëndimit…”. “Këta, - pohonte në atë kohë S.Pollo, – janë kozmopolitë dhe, si të tillë, ne duhet t’i luftojmë”. “
Prof. Bahri Beci**, Gazeta Panorama,16Korrik 2013**
FLETËRRUFEJA 1 – PRILL1967 Fletë-rrufe Kundër Eqrem Çabejt
Disa probleme themelore të historisë së vjetër të gjuhës shqipe, Konferenca I e studimeve albanologjike, dhe në diskutimin tuaj të fundit.) Në dispensën tuaj “Hyrje në historinë e gjuhës shqipe” ju flisni gjerësisht për shkencëtarët e huaj që janë marrë me gërmime arkeologjike, kurse për rezultatet e arritura nga arkeologjia shqiptare mjaftoheni me një paragraf të thatë e të përgjithshëm. Pse ky qëndrim?
Skënder Anamali / Hasan Ceka / Dhimosten Budina / Bep Rebani /HënaSpahiu /Muzafer Korkuti / Zhaneta Andrea
PËRGJIGJJA 2 e Eqerem Çabejt:
PËRGJEGJE KOLEKTIVIT TË SEKTORIT T’ARKEOLOGJISË
Meritat e arkeologjisë shqiptare i kam vënë në dukje në vendet që citohen në përgjegjen time të parë. Ndërkaq kam rezervimet e mia parimore lidhur me barazimet: kulturë prehistorike = etnos = gjuhë, sidomos për sa i përket fushës së gjuhësisë.
http://shqiptarizmi.com/2010/12/fletrrufe-kunder-eqrem-cabejt/

LËNDA

Adrados F R, “Historia dela lenguea griega” Madrid 1999.

Anonim, “Fjalori Grekoshqiptar” Pandora 10 (1860), 11 (1861).

Aravandinos. P, “Fjalori Eipriot”, Athinë1909.

Aravandinos P, “Xronografia tis Ipiru”, (Kohëshkrimi i Epirit) Athinë 1857.

Bello L, “Alvanika i e tris zuse dhialekti tis ellinikis glossas”. (Shqipja njëra nga tre dialektet e shpëtuara të gjuhës greke) Athinë 1903.

Blanchus F, “Diktionarium Latino-epiroticum”, Romë 1653.

Bopp F. “Uber das Abanesische in seinen verwandschaftlichen” Beziehungen. 1854.

Cabanes P. Drini F, “Corpus des iscriptions grecques d’Illyrie meridionale et d Epire”.

Camarda D. “Saggio di grammatologia sulla lingua albanese”. Livorno 1864.

Camarda D, “Tre canzoni popolari albanesi dell Epiro concernenti l’insurrezione greca”. Livorno 1875.

Çabej E. “Hyrje ne historinë e gjuhës shqipe”, Tiranë 2008.

Çabej E. “Studime Etimologjike në fushë të shqipes”, Tiranë 1982.

Chiro G, “Te dheu i huaj”, Palermo 1900.

De Rada J , “Poesie Albanesi”, Napoli 1847.

De Rada J, “Flamuri arbërit”, Tiranë 1957.

Dorsa V, “Sugli albanesi. Ricerche e Pensieri”, Napoli 1847.

Demiraj Sh, “Etruskët, Pellazgët, Ilirët dhe Shqiptarët”. Tiranë 2008.

Fallmerayer Von Dr. J. Ph, “Das Albanesische element in Griechenland”. Munchen1857. Me 1860 boton vazhdimin e dy vëllimeve të tjera (II edhe III) me të njëjtin titull.

Frashëri A, XH. B. LOG, “Mbledhja e Prizrenit” 1989.

Frashëri N, “Vepra, Vëllimi I” Prishtinë 1982, “Vëllimi II”, Tiranë, 1978.

Frashëri N, “Dituria”, Nr 12, Stamboll 1885.

Frashëri S, “Vepra I”, Tiranë 1988, “Vepra, vëllimi i II“”, Tiranë 1989.

Frashëri S, “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhet”.

Furiqi P, “I en Atiki ellinoalvaniko dhialektos”, (Dialekti grekoshqiptar i atikes) Athinë 1933.

Giordano E, “Dizonario degli Albanezi d’Italia”, Bari 1963.

Gjini N , “Fjalori Shqip Greqisht”, Tiranë 1971.

Gjecovi-Kryeziu Sh, “Vepra të zgjedhura”, vëllimi II, Prishtinë 1988.

Hahn . J G. Von, “Studime Shqipe”, Jena, 1854

Hesychii Alexandrininos Lexicon: Mauricio Schmidt, Jenae, MDCCCIXL.

Hesychii Alexandrininos Lexicon, Kurt Latte, Peter Allan, Copenhagen 1953

Homeri, “Iliada”

Homeri, “Odisea”

Herodoti, “Historia”

Hesiodi , “Theogonia”

“Ilirët dhe Iliria në autorët antikë” Akademia e shkencave Tiranë.

Kacaros V, “Leksiko Suida”, Thirathen, 2002.

Konda S, “Shqiptarët dhe problemi pellazgjik”. Tiranë 1964.

Kocaqi A F, “Shqipja Pellazge”. Tiranë 2009.

Kocaqi E,“Roli pellazgo ilire në krijimin e kombeve dhe gjuhëve evropiane”.

Kocaqi E, “Shqipja çelësi i gjuhëve indoevropiane”. Tiranë 2008.

Kopidakis M. Z, “Historia e gjuhës greke”. Athinë 2000.

Kupitori P, “Alvanika Melete”. Athinë 1879

Kurilas E, Grigorios o Argjirokastritits, (Grigor Gjirokastriti) “Teologjia 8”, 1930.

Krispi Z, “Memoria sulla linguea Albanese”. Palermo 1831.

Leake M, W, “Researches in Greece”, Londër 1914.

Meyer G, “Fjalori etimologjik i gjuhës shqipe”. Tiranë 2007

Paparigopulos K, Paulos Karolidhu, “Isagogji is tin istorian tu elliniku ethnus” (Hyrje në historinë e kombit grek)

Pott A, “Etimologische Forschungen auf dem Gebiet der indo-germanischen Spraschen”, 1833-1836.

Papadhimitriu A, “Pelasgji”, Athinë 1994

Tagliavini C, Albania, “Lingua. Enciklopedia Italiana. vol 2” (1929) 123.

Tasi K, “Leksiko Ellino-Albaniko” (Fjalor Greqisht-Shqip) Athinë 1928.

Thimi M, “Vepër”, Tiranë 1981.

Thomopulos I, “Pellazgjika” Athinë 1912.

Thomopulos I, “Pellazgjika: Shumerishtja shqipja e lashtë“. Athinë 1933.

Thukididi, “Historia e luftrave të Peleponezit”.

Straboni, “Gjeografia”.

Schlecher A, “Compedium der vergleichenden Grammatik der indogremanischen Spraschen”, 1861-1862.

Vreto J, “Vepra të zgjedhura, Tiranë 1973.

Xylander Von, “Die Sprasche das albanesen order Schkipetaren”. Frankfurt 1835

G Stier, “Die Albanisischen Thiernamen”, 1862.

PARATHËNIA

Fjalët e përbashkëta në gjuhët evropiane dhe në një dialekt të indishtes, u bënë shkaku i lindjes së shkencës krahësimtare: indoevropianistikës. Kjo shkencë nxorri si përfundime se këto fjalë të përbashkëta vijnë nga e njëjta gjuhë mëmë që është folur dikur në një pellgë, por që ende dhe sot nuk kemi një mendim unik për atë pellgë. Syri i gjuhëtarit, në shkencën krahësimtare, i shikon gjuhët evropiane me bazë dokumentimin më të hershëm gjuhësor dhe me këtë bazë vendon se në se ka fjalë të përbashkëta midis dy gjuhëve evropiane atëherë gjuha që dokumentohet me vonë e huazon nga gjuha e dokumentuar më herët. Sipas gjuhësisë sonë gjuha shqipe dokumentohet më vonë se një mori gjuhësh ndër fqinjët tanë, ndaj në fjalorët etimologjik ajo meret si gjuhë që ka huazuar fjalët e fqinjëve për tu krijuar.

Në këtë punim unë do paraqes dokumente që kanë të bëjnë me kohë dokumentimin më të vjetër të fjalëve të gjuhës shqipe duke shkelur mbi themele të fuqishme të kryes së gjuhësis evropiane. Mbetjet origjinale të gjuhës së paragrekve, Pellazgëve, janë tregues të pakundërshtueshëm gjuhësor që tregojnë egzistencën e gjuhës shqipe, më vjetër se vetë greqishtja dhe si rrjedhojë ndryshojnë llogjikën e syrit të gjuhëtarit në lidhje me gjuhën shqipe.

Ashtu si të gjitha gjuhët evropiane që kanë marrë e kanë dhënë fjalë nga njëra tjetra me bazë zhvillimet e ngjarjeve historike, po kështu dhe shqipja ka marë fjalë nga gjuhët fqinje në kohë më të reja. Në se ne krahasojmë këto huazime me njëra tjetrën pa marrë për bazë historinë dhe dokumentimin më të hershëm të fjalëve të një gjuhe, atëherë dalin përfundime të shtrembëruara dhe të padrejta. Ndaj dhe ky punim vjen për të saktësuar rolin e shqipes në gjirin e gjuhëve motra evropiane. Baza e këtij punimi do jenë mbetjet origjinale të gjuhës së paragrekëve=Pellazgëve, të shpëtuara nga dokumentimi i fjalorëve të antikitetit.

Altin Kocaqi

HYRJA

Herët në shekullin e 19 fillon e shfaqet në arenën e gjuhësisë evropiane çështja e gjuhës shqipe. Themeluesi i gjuhësisë krahësimtare, Franc Bopp, (1854) e vendos shqipen ndër gjuhët e vjetra, por pa e klasifikuar atë. Para tij gjuhëtaret August Schlesheri (1850) dhe August Pott (1833-1836) arrijnë në përfundimet se “shqipja hyn në gjuhët klasike, por është më e vjetër se ato”.

Por bazën e historisë së gjuhës shqipe do ta vendoste G. Hahn (1854) me “Studimet Shqipe”, ndërsa mbështetja gjuhësore e shqipes do jepej nga nga gjuhëtaret G. Stier (1862) dhe D. Camarda (1864).

Më 1912 Iakovo Thomopulo me ndihmën e mësuesve të shqipes, Petro Xhovanit dhe Evlogjio Korilas, do vinte dhe do vuloste vërtetësinë e autoktonisë sonë duke zbardhur nje mori mbishkrimesh të herëshme.

Rilindasit i mbështetën me zell dijetarët e mësipërm…por diçka shkoi keq në vazhdim! I pari ishte serbokroati Miklosiçh ai që “do vinte re” se Shqiptarët janë pasardhës të ilirëve por nuk janë autoktonë me bazë gjuhën e tyre me shumë andra! Pas tij erdhi Gustavo Meyer dhe i

kushtojë të parit "Fjalorin Etimologjik" të gjuhës shqipe duke arritur në të njëjta përfundime se "shqiptarët flasin një dialekt të ilirishtes dhe i mbajnë këto troje të paktën pas shek 10 es pas serbëve. Kocka e hedhur nga këta "dijetarë" u lëpi gjatë epokes të bolshevizmit dhe vazhdon të lëpihet ende deri në ditët tona. Mesazhi që ju percoll botës me anë të duarve tona ishte se: "Shqiptarët dhe shqipfolësit kudo në rajon duhet të ulin kokën se janë ardhacakët e fundit". Kocka qe i tregonte Shqiptaret"pasardhës" te Ilirve ishte nje kockë e rreme, pasi as Miklosiçhi as Meyer e as Çabej me Demirajn nuk dhanë ndonjë provë për shkrimin e ilirishtes: edhe perse ka prova te pakundershtueshme per dokumentimin e saj!

TË THËNAT MBI GJUHËN SHQIPE

Në kohët kur shfaqet si e njohur historia e mesdheut evropian, në pellgun tonë krahas grekëve dhe latinëve janë të njohur dhe iliret si banues të një hapsire të madhe1. Në vendin e tyre dhe në malin e Tomorrit gjendej faltoria e vjetër e Pellazgëve, të cilës i këndoi Homeri2 dhe Hesiodi3. Kjo faltore tregohet të jetë më e vjetra dhe e vetmja që nga lashtësia4 gjë që tregon se "në se ne shqiptarët, që jemi pasardhës të drejtpërdrejt të ilirëve, vërtetohemi gjuhësisht se flasim gjuhën e Pellazgëve më të vjetër se kudo tjetër në zonë ne jemi vëndas në truallin tonë të sotëm". Në fjalorët e hershëm të greqishtes së vjetër njihet rëndom prej kohësh egzistenca e një grupfjalëshi të huaj për gjuhën greke që janë përkthyer në greqisht nga njohësit e të dyja gjuhëve qysh prej periudhës së antikitetit nga fjalorëshkruajtësit5 e atyre kohëve. Këto fjalë njihen si "mbetje origjinale te gjuhës së paragrekve. Për mbetjet e fjalëve të vjetra paragreke, Eqerem Çabej na thotë se "nëse ka ndonjë lidhje mindis gjuhës së paragrekëve dhe shqipes, ky problem lidhet me Pellazgët"6. Që herët, nga themeluesi i gjuhësisë indoevropiane, Franc Bopp, u vu re se shqipja hyn në gjuhët e vjetra, por ai nuk përcaktoi familiaritet të saj me gjuhët klasike7. Nxënësi i Boppit, August Pott, e cilëson shqipen si gjuhë Iliropellazge që nuk ka lidhje me greqishten e latinishten, por është gjuhë8 paraindoevropiane9.

Në shekullin e 19 kur Evropa e Revolucionit Francez kishte hedhur bazat e krijimit të kombeve, gjuhësia e saj po vërtetonte se: shqiptarët nën Turqinë myslimane duken të jenë ata të cilët flasin gjuhën më të vjetër të gjuhëve motra indoevropiane, që me fjalë të tjera do të thoshte dhe prejardhjen e fjalëve motra në gjuhët e tyre. Siç duket kjo nuk ishte aspak e pëlqyshme, ndaj çuditërisht në horizont shfaqet serbokroati Mikolosiçh dhe pasuesi i tij Gustav Meyer të cilët themelojnë një tjetër rrugë për prejardhjen e gjuhës shqipe. Atë rrugë që na do këtu të ardhur pas shek 10 e s, por që flasim një dialekt të ilirishtes e cila s ka dokumente-ndaj si rrjedhojë mbetet vetëm "të ardhur pas shek 10 e s pas serbëve"

Pra historikisht kemi dy grupmendime për lashtësinë e shqipes:

1-Mendimi që thotë se shqiptarët janë të ardhur në këto troje: Meyer, Miklosiçh, Çabej, Demiraj etj

2-Mendimi që thotë se shqiptarët janë vazhdues të autoktonisë absolute pellazgoiliriane, Hahn, Camarda, Stier dhe Rilindasit shqiptarë etj.

Do i marim çështjet në shqyrtim me radhë duke u nisur nga grupmendimi i parë:

Shqiptarët jo autoktonë absolut: Meyer, Çabej, Demiraj!

Mendimi i Gustavo Meyerit:

Fjalori i tij etimologjik[10] përmban 5140 fjalë, nga këto 1420 ai i nxjer me prejardhje romane, 540 i nxjer me prejardhje sllave, 1180 me prejardhje turke, 730 të padepërtueshme dhe për këtë ai fajëson mospërmbledhjen akoma të gjuhëve të tjera në Evropë, ku ai shpreson në të ardhmen të depërtohen e të zvogëlohet ky numër. Për 400 fjalë thotë se "pak a shumë''i njeh si trashgimni të lashtë indoevropiane… por nëpërmjet paralelizmave sllavo-turke etj. Me pak fjalë G. Meyer që pranon se "nuk e njeh gjuhën shqipe" dhe ndërton fjalorin etimologjik

te saj, na thotë se: Gjuha shqipe është sajesë e krijuar nga huazimet e fjalëve të gjuhëve të fqinjëve dhe jo një gjuhë me bazë autoktone! Carlo Tagliavini e hedh poshtë veprën e Meyerit si vepër me fjalë të huaja që përdoren ndër arvanitët, arbëreshet, arnautët e gjetkë, por që nuk kanë asnjë lidhje me trungun e gjuhës shqipe[11]. Për këto arsye po marim për shqyrtim 60 fjalë në 14 faqet e para të fjalorit të tij dhe pikërisht atë element të huaj që "nuk hiqet me një fjalë goje"

"Abat, abaci, abdest, abdhele, abisonj, abolla, abonsina, acik, addunar, aformi, aftapodh, agapis, ahci, ajan, ajazem, ajodhime, akatastasi, aksafana, aksi, aksua, alabaster, alun, alaka, alem, alemistra, aleshtis, alimonore, alipsan, alsive, allanor, alltebash, ambnis, anak, anamesa, aname, anangas, andikos, andis, angalias, angonje, angosinj, angure, agjin, agjinidhe, agjister, anthine, apalto, apanses, apikas, apodhure, apofasi, apomoni, apostull, apoth, apsith, apul. arallek, arcere, arenc, argali, argat"

A ekziston një vend i vetëm ku të jetë folur kjo gjuhë "shqipe" me element grek, italian, turk e sllav? Ku dokumentohet një gjuhë shqipe që të ketë brenda saj të gjitha këto elemente? Këto fjalë janë dokumentuar veçanërisht ndër arvanitët, arbëreshët, arnautët, si huazime të brëndëshme krahinore, por nuk kanë asnjë lidhje me trungun e gjuhës shqipe dhe si rrjedhojë as Meyer nuk ka asnjë pikëlidhje gjuhësore me shqipen, të cilen ai e pranon vetë se nuk e njeh. Lidhjet e Meyerit me gjuhën shqipe, të pakten gjatë periudhës që shkruajti këtë fjalor, me shumë i afrohen një strategjie politike antishkencore të mirëorganizuar nga perandoria bavariane e cila "riprodhoi" Grekët në Athinën e Arvanitve, që historikisht njihen nga demaskimi i Fallmeayerit[12], për të rikthyer lavdinë e zvenitur të epokës se "helenizmit të Isokratit"[13] dhe jo vetëm. Një faqe e vetme dhe e veçantë në hyrje i kushtohet emrit të serbokroatit Miklosiçh duke na treguar "dashurinë" serbe për gjuhën shqipe dhe autoktoninë tone.[14] Qëllimi i Meyerit vërtetohet të jetë ç'bëria e krenarisë sonë autoktone në rajon, në mënyrë që shqipfolësit të tregohen ardhacakër e të ulin kokën, dhe mbi ta të vërshojnë sulmet barbare me dëbime nga trojet e tyre si ardhacakër. Kjo del në pah kur ai "futet në çështjet politike të dogmave"[15]:

"Mendoj se patriotët shqiptarë dhe grekët nevojtarë për aneksimin, te cilët e kanë të domosdoshm dogmën për lashtësinë e madhe të çdo fjale shqipe si mbështetje për teorinë e tyre pellazgjike, ose të çfarëdolloj teorie, kur të marrin në dorë librin tim nuk do gëzohen shumë për mozaikun shumëngjyresh që paraqitet këtu".

Me pak fjalë qëllimi i Gustavo Meyerit është që të vërtetojë se shqiptarët nuk janë autokton por të ardhurit e fundit në këto troje pas shek 10 te erës sonë =pas serbëve.

Çabej vë në gojë Kretschmerin që i tregon si të drejta përfundimet e Gustavo Meyerit se[16]:

"Shqiptarët flasin një nga dialektet e ilirishtes dhe i mbajnë këto troje të paktën pas shek 10 të erës sonë"

Ose e shprehur me fjalët e Çabejt [17]:

''Nje etapë të re ne këte fushë shënon puna e Gustav Meyrit. Ky në ketë çështje shpreh mendimin që gjuha shqipe paraqet fazën më të re të njërit nga dialektet e vjetra ilire''

Sigurisht që 400 fjalët që Meyer i njeh pak a shumë si trashgimni e lashtë indoevropiane nuk do të thonë në asnjë mënyrë se janë fjalë të shqipes, pasi "trashgimni e lashtë indoevropiane" quhen "fjalët e njëjta në gjuhët motra evropiane" të cilat sipas shkencës indoevropiane, të shprehur dhe nga Çabej[18], "i paraqiten syrit të gjuhëtarit me bazë dokumentimin më të hershëm të një gjuhe. Në një kohë që, sipas gjuhësisë shqiptare, shqipja dokumentohet e fundit në rajon dhe kështu që, sipas gjuhësisë, ato 400 fjalët e Meyerit llogariten me "syrin e gjuhëtarit". Kjo do te thotë se ne kemi marë fjalët "motra" të fqinjëve për të ndërtuar gjuhën tonë. Gjuhësisht autoktonia jonë është e zhveshur përballë rrebeshit të

“akademikëve”. Me rikthimin nga interrnimi të Dhimitër Pilikës të interrnuar nga “bretkosat e moçalit sepse mbronte autoktoninë tonë” [19,] u duk se do hapej dhe rruga për rishikimin shkencor të cështjeve të autoktonisë sonë. Fatkeqsisht jo! Dija shqiptare vazhdoi dhe vazhdon akoma të mbrojë doktorinën antirilindase dhe në kuadër të saj urimi i ëmbël që i jep veprës së Meyerit, Seit Mansaku [20].

“Le ti urojmë dhe këtij botimi në shqip të fjalorit të G Meyerit të tërheqë pas vetes sa më shumë studiues të zellshëm të gjuhës shqipe dhe të historisë së saj që të dinë të çmojnë veprën e këtij dijetari të shquar, të përfitojnë prej saj dhe ti çojnë me tej arritjet e deri më sotme nç studimin e historisë së gjuhës shqipe”

Mendimi i Çabejt dhe i Demirajt !

Eqerem Çabej dhe Shaban Demiraj janë dy gjuhëtaret e njohur të epokës së shkuar të cilët kanë lënë gjurmët e tyre në ndërtimin dhe përsosjen e shqipes letrare. Çabej u nda nga jeta në epokën e bolshevizmit, ndërsa Demiraj rron edhe në ditet tona. Ai ndryshon nga Çabej në pikën që njeh e pranon se mbishkrimi i Limnos është mbishkrim pellazgjik si dhe praninë pellazgjike në trojet aktuale shqiptare[21], ndërsa për preajardhjen e gjuhës shqipe të dy janë thuajse i të njëjtit mendimi: Çabej thotë se:

“Si të gjithë popujt indoevropianë dhe Shqiptarët janë të ardhur në viset e tyre historike… . Ne për arsye metodike, në lidhje kryesisht me dëshmitë e gjuhësisë, e shtrojmë brenda këtij caku të kufizuar: A janë Shqiptarët vendas në këto anë nga epoka greko romake apo jo? E shtruar në këtë mënyrë me një anë pajton me rrethanën që qysh në kohën greko-romake dihet me siguri që fise ilire banonin në Shqipëri… ”[22]:

Ndërsa Demiraj:

“Për me tepër, tashmë është me se e qartë se etnosi shqiptar, arbërsh, siç quhej dikur, është formëzuar herët në brigjet lindore të Adriatikut dhe të Jonit, për çka dëshmojnë, ndër të tjera, huazimet nga greqishtja e vjetër dhe latinishtja në gjuhën shqipe”[23]. **Megjithese me duhet ta pranoj se te pakten Eqerem Cabej nuk u la i lire te bente punen e tij. Shqiptarët autoktonë: Hahn, Camarda, Stier, Rilindasit!**

Mendimi i Hahnit!

Vepra e tij “Studime Shqipe”[24], e përkthyer tashmë dhe në gjuhën shqipe, duket ti qendrojë kohës më shumë se cdo vepër tjetër e krijuar për historinë dhe gjuhën shqipe, pasi kudo që flitet për historinë tonë dhe gjuhën shqipe ai meret i pari në shqyrtim. Përfundimet e tij janë si më poshtë:[25]

1-Epiriotët dhe Maqedonët ishin dhe në kohën e Strabonit jo grekë, por barbarë.

2-Epiriotët ilirët e maqedonët janë farefis midis tyre.

3-Ka shumë shënja që epiriotët dhe maqedonasit përbënin thelbin e fisit Tirrinopellazgjik që shtrihej në skaje deri në Itali dhe Thrakë, ndërsa në brendësi shkonte deri në lumin Danub.

4-Ilirishtja është gjuhë pellazgjike me kuptim më të gjërë.

Hahnin e madh nuk mundi kush ta kundërshtonte ne tre pikat e para, ndërsa për piken e katërt Eqerem Çabej shprehet midis “dy të panjohurave”, sipas tij, se “kjo nuk qëndron se sipas gjithë gjasave ilirishtja dhe pellazgjishtja janë dy gjuhë te ndryeshme”[26] Pra Çabej që nuk njeh ndonjë shkrim të ilirishtes dhe as që pranon ndonjë shkrim të pellazgjishtes, “njohka” se s‘ka lidhje midis dy “të panjohurave”!!

Mendimi i D. Camardes, G. Stier dhe i A. Pott…. !

D Camarda[27], G Stier[28], edhe A Pott[29], A Schleisher[30], Franz Bopp[31] duke u bazuar në provat krahesimtare të pestë gjuhetarët e famshëm venduan se shqipja hynë në gjuhët e lashta

dhe renditet më e vjetër se greqishtja dhe latinishtja.- Për të dhënat e mësipërme shih mes te tjerash : Carlo Tagvlianin 1929, Panajoti Kupitorin 1879, Iakovo Thomopulu 1912 etj.

Duke qenë se në vendin tonë ende dhe sot nuk kemi të drejta të barabarta në studimin e grupmendimeve për cështjet e histories dhe gjuhës sonë, pasi akademia jonë e shkencave mbajti dhe mban akoma qëndrimin e rrugës së pro meyeristave, po i marrim të dhënat nga arvanitët e Greqisë:

Cili është Demetrio Camarda sipas Iakovo Thomopulu [32]:

"Lindi në Piana dei Greci (Albanesi) (15 km ne Jug të Palermos) ku më 1488 ishte krijuar kolonia kryesore e Shqiptarëve të Siçelisë . Kane si kishe të parë naon e kishës së Shën Dhimitrit (Selanikasit) dhe si gjuhë të fesë ruajtën gjuhën greke"

Εγεννήθη εἰς τὴν Piana dei Greci (15 χιλιόμετρα νοτίως τοῦ Palermo), ὅπου τὸ 1488 εἶχεν ἱδρυθῆ ἡ κυριωτέρα Ἀλβανικὴ ἀποικία τῆς Σικελίας. Ἔχουν ὡς κύριον ναὸν τὴν Ἐκκλησίαν τοῦ Ἁγίου Δημητρίου (τοῦ Θεσσαλονικέως) καὶ ὡς γλῶσσαν λατρείας διετήρησαν τὴν Ἑλληνικήν.

Historiani Pavlo Karolidhu (1849-1930) shkruan nën përmbledhjen e Konstandino Paparigopulos "Hyrje në historinë e kombit grek"[33] dhe pranon përfundimet e Demetrio Camardës që: "vërtetoi me anë të mbetjeve origjinale të gjuhës së Homerit, se shqipja është gjuhë parahomeriane ose siç e quajti ai "Gjuha e Perëndive". Ndërsa Thomopulo[34] na thotë se: ***"Teoria e prejardhjes së perbashkët e grekëve, shqiptarëve dhe e latinëve njohu një pranim të gjerë. Në Itali përkrahësi entuziast i kësaj teorie u bë italoshqiptari Demetrio Camarda (1821-1882), njëri nga themeluesit e gjuhësisë shqipe, njohës i shkëlqyer i greqishtes së vjetër, poet dhe adhurues i Homerit, me prejardhje nga shqiptarët që pas "pushtimit turk u shpërngulen" në Italinë e Jugut në Siçili. Më 1864 do botojë "Prova krahësuese gramatologe të gjuhës shqipe" në të cilën nxori si përfundim se: gjuha shqipe përbën gjuhën parahomeriane sipas fjalëve origjinale që kanë shpëtuar nga lashtësia. Këtë e gjajësoj me Gjuhën e Perëndive, ashtu siç e quan Homeri gjuhën e shumëvjetër të cilës pak fjalë i kishin shpëtuar nga poeti deri në kohën e tij"***

Por kundra Camardës doli i pari Mayer me fjalorin e tij etimologjik dhe me vonë Eqerem Çabej i cili nuk gjykoi kurrë veprën e tij, por "teorinë" megjithëse "teoria e Camardes" i ka shumë të qarta përfundimet e veta të cilat duhej ti kishte marë në shqyrtim e ti kundërshtonte.

Eqerem Çabej gjykon tezën "të prejardhjes së përbashkët të gjuhëve klasike, greqishtes, latinishtes, shqipes dhe me bazë "tezën" e kundërshton teorikisht e jo gjuhësisht veprën gjuhësore të Camardes ***"Kjo tezë, të cilën e ndoqi dhe G Stier e Dhimitër Camarda, arberëshi i njohur prej Hores së Arbëreshëve në Siçili (1821-1882) u pa se nuk ishte e drejtë. U vu re se greqishtja me latinishten nuk kanë ndonjë lidhje të ngushtë prej epokës prehistorike. As shqipja nuk ka ndonjë afri të veçantë me to, megjithëse ka disa konkordanca me greqishten, që do ti shohim më poshtë. Një tjetër rrethanë që solli ngatërime në tezen e këtyre dijetarëve ishte se ata nuk qenë në gjëndje të dallonin huazimet që ka shqipja prej greqishtes e latinishtes, nga fondi autokton i saj, duke operuar me ato të parat sikur të ishin fjalë vëndi të shqipes"***[35.] Por vallë a dinte ti dallonte huazimet Demetrio Camarda ky njohësi i shkëlqyer i Homerit, i greqishtes së vjetër si gjuhën e kishës, i shqipes mëmë, i latinishtes dhe i italishtes që njëkohësisht ishte dhe gjuhëtar dhe që librin e vet ju a kushtojë "të dashuruarve me gjuhësinë"? Eqerem Çabej e dinte fort mirë se puna e Demetrio Camardes ishte rruga e vetme dhe e vërtetë gjuhësore që na çon tek gjuha e Pellazgëve, por vallë përse kjo dygjuhësi nga Çabej?

„Një interes të veçantë për gjuhësinë shqiptare paraqet çështja a ka ndonjë lidhje midis gjuhëve ose gjuhës së substrakteve paragreke të Greqisë së vjetër dhe gjuhës shqipe, ose mbeturinave të atyre substrakteve në këtë gjuhë. Ky problem lidhet me emërin e Pellazgëve edhe të pellazgjishtes" [36]

Mendimi i Rilindasve

Rilindasit e rrokën me entuziazëm shkencën e gjuhësisë evropiane dhe e mbështetën teorinë e prejardhjes autoktone të shqiptarve, ashtu siç do të vepronte cdo shqiptar me këmbë në tokë dhe jo me këmbët e "idealeve universale" të një bote internacionaliste mbi kurrizin e kombit. Hahni dhe Camarda fituan simpatinë e Rilindasve dhe nuk janë të pakta vargjet që këta shkruajtën mbi prejardhjen tonë. Naimi tek Pellazgjit Shqiptarë shkruan:

Gjuhë që flisnin Perëndit / Atë flisnin Pellazgjitë / Atë kanë dhe Shqiptarët / Sikurse dhe të parët.

Sigurisht që ata nuk mund të arinin të përkryerën por të paktën nuk u kursyen kurrë të mbronin atë anë të shkencës që vertetësisht vendonte se "ne jemi autoktonët e vetëm në këto troje", ndaj shqiptarë kudo që jeni ngrini kokën dhe krenohuni që jeni shqipfolës. Por ide të kundërta ja arritën të kalonin "meyerat", me shqiptarë ardhacakër, duke i lënë shqipfolsit në mëshirën e asimilimit nën hijen e kërcënimit të dëbimit me dhunë të ardhacakëve. Ky "genoncid" ka dhe mbështetjen e dijes shqiptare deri ne ditët tona. Ky është ndryshimi midis "konceptit universal" dhe përdorimit të shkencës në jetëgjatësinë e një kombi: e para u aplikua nga gjuhëtarët shqiptarë të kohës së bolshevizmit e deri në ditët tona dhe e dyta ndër fqinjët tanë. Në këtë pikë jam i ndërgjegjshëm se ngjyrat janë vetëm bardhë e zi.

Sigurisht që nuk qëndron mendimi i Samiut dhe i Naimit vetëm në pikën se "nga erdhën Pellazgjitë", pasi ky mendim përkon me ndikimin e përhapjes së njerëzisë sipas botkuptimit fetar. Historikisht Homeri dhe Herodoti tregojnë vendin tonë dhe malin e Tomorrit si kryeqendrën më të herëshme të Pellazgëve, gjurmët e së cilës erdhën deri në epokën e bolshevizmit. Në këtë epokë disa kallëpe dinamiti hodhën në erë një nga mbrekullitë e botës. Le të shpresojmë se një ditë do rihapet faltoria e "Të mirëve" dhe nuk do jenë shkatërruar dokumentet brënda saj.

Mendimi i Iakovo Thomopulos

Iakovo Thomopulo, "Pellazgjika, Athinë 1912 *ribotimi i 1994"*, nga 7 ishujt përtej Epirit, me ndihmën e dy mësuesve të shqipes[37] Petro Xhovanit nga Elbasani dhe Evlogjio Korilas nga Korça ja arriti të zbardhë një mori mbishkrimesh me anë të gjuhës shqipe, mes tyre dhe mbishkrimin e Limnos që Demiraj më sipër e pranon tashmë si Pellazgjik. Gurët filluan të flasin në duart e Thomopulos dhe e folura e tyre vërtetoi shqipen si gjuhën e mbishkruajtësve. Por jo vetëm mbishkrimet e pellgut pellazgjik nga Etruria në Azinë e Vogël por dhe mbështetja historike tek antikiteti dhe tek Hahn i madh si dhe mbështetja gjuhësore tek filologu Demetrio Camarda, te cilin Thomopulo e quan "themeluesin e filologjisë shqiptare". Për Thomopulon mjafton të përmendim se si teorikisht dhe gjuhësisht mbrojti Hahn dhe Camardën dhe duke hipur mbi supet e tyre zbardhi me anë të gjuhës shqipe mbishkrime dygjuhëshe etruskolatine, likogreke, keroegjyptiane, etekretane, mbishkrimin e Limnos etj, në një kohë që ana etruske, like, kerike ishte shkruajtur në gjuhë të ngjajshme me shqipen tonë. Në punimin e 2009, "Shqipja Pellazge", shb Marlin Barleti, solla në shqip disa pjesë nga puna e Thomopulos duke shkuar pak më tej me mbishkrime nga Kreta minoike dhe nga Pilua i famshëm i Nestorit të Homerit. Po kështu nën gjurmët e Thomopulos lexuam fjalë shqipe në një mbishkrim të përzier ilirogrek nga 8 radhësi i Dimalit.

SHKENCA E KRAHESIMIT TË FJALËVE (INDOEVROPIANE)

Prej kohësh është vrëjtur se mindis gjuhëve evropiane dhe një dialekti të indishtes egzistojnë fjalë të njëjta. Ky fakt i shtyu dijetarët që drejtësisht të vendonin se "fjalët e përbashkëta ne gjuhët evropiane tregojnë se dikur në lashtësi egzistonte një pellg në të cilin

flitej e njëjta gjuhë", këtë ata e quajtën "mëmën e gjuhëve". Deri këtu kjo teori qëndron e ka për të qëndruar për shekuj të tërë. Por kur vjen çështja të diskutojmë se "cili është pellgu?" gjërat ngatërrohen aq shumë sa dijetarëve ju duhet të shkojne në Indi e Kinë, Afganistan, Kaukaz e Iran dhe prapë të vijnë në Ballkan dhe Evropë për të na thënë se këtu apo aty është pellgu. Pra deri me sot nuk mund të flasim me siguri për pellgun e prejardhjes së gjuhëve evropiane, atë pellg ku është folur mëma e gjuhëve.

Që herët u kryen punime fillestare mbi fjalët e gjajshme në gjuhët evropiane dhe me kalimin e kohëve u dokumentuan. Përpara shkencës tani hapej një rrugë e re dhe më e vështirë akoma që duhej të shpjegonte se cila është radha e prejardhjes më të vjetër të fjalëve. Por kjo çështje nuk mund të zgjidhej shkencërisht dhe pikërisht ketu ndahet qëllimi nga shkenca. "Qëllimi" ishte të vihej një radhë studimi në prejardhjen më të vjetër të fjalëve ndërsa përfundimi ishte:

''Gjuhët indoevropiane janë dëshmuar me anë te shkrimit në perioda të ndryshme, e kështu ato i paraqiten syrit të gjuhëtarit në shkallë të ndryshme të lashtësisë e të zhvillimit të tyre. Ndërsa prej hetishtes, indishtes, greqishtes kemi dëshmi që nga mesi ose mbarimi i mijëvjëçarit të dytë para erës sonë, e nga iranishtja e gjuhët italike prej antikes, gjuhët gjermanike njihen prej shek IV të erës sonë me biblën në gotishte, armenishtja në shek V, keltishtja në shek VII, sllavishtja me sllavishten kishtare e biblës se vllezërve Ciril nga shek IX i erës sonë. Gjuhët baltike dëshmohen me shkrime aty nga shek XV-XVI. Po kjo vlen dhe për gjuhën shqipe '' [38]

Pra ky është rendi i shkallës së lashtësisë në studimin gjuhësor të gjuhëve motra indoevropiane, kështu i paraqiten syrit të gjuhëtarit, që me pak fjalë do të thotë :

"Në se midis sllavishtes dhe shqipes ka fjalë të perbashkëta, atëherë gjuha që dokumentohet më vjetër është sllavishtja si rrjedhoj shqipja e dokumentuar me vonë e ka huazuar nga sllavishtja".

Pikerisht këtu hyn punimi im i cili vërteton se fjalët e gjuhës shqipe dokumentohen si në mbishkrimet e lashta dhe në "mbetjet origjinale të gjuhës së paragrekëve", mbetje që ashtu siç e pranon dhe Çabej "i perkasin gjuhës së paragrekëve=pellazgëve

Sigurisht që unë nuk mund të fajsoj diturinë evropiane në lidhje me gjuhën shqipe edhe lashtësin e saj pasi vetë kryeja e saj hodhi bazat e albanologjisë duke e vendosur shqipen në krye si gjuhën më të vjetër. Faji bie mbi vetë gjuhësinë tonë që ndoqi dhe po ndjek verbërisht Gustav Meyerin, ndaj për këtë arsye, duke u bazuar edhe në shkencën krahësimtare, në vazhdim po marrë në shqyrtim një grup fjalësh, nga ato pak fjalë shqipe që egzitojnë në fjalorin e Gustav Meyerit, pasi siç përmëndëm më siper "shumica e fjalëve të Fjalorit të tij nuk kanë asnjë lidhje me trungun e gjuhës shqipe.

Fjalën "krera" Meyer e sjell si një huazim të shqipes nga latinishtja "cereburin", si edhe nga rumanishtja "crier". Por kjo fjalë gjendet e dokumentuar si "mbetje origjinale e gjuhës së paragrekëve" e dokumentuar nga Hesychii Aleksandrinos si**:** **κρατῆρα· τὴ κεφαλή,**" krera" që në greqisht përkthehet si fjalë e huaj: "i qefali=koka". Pra shqipja ruan origjinalin paragrek të pandryshuar . Do duhej vetëm një llogjikë e çmendur që fjalën "krera" të paragreqishtes ta bënte "cereburun" dhe pastaj ta kthente në shqip prapë "krera".

Fjalën "nis" Meyer e huazon nga Miklosiçh për të na thëne se huazohet nga greqishtja e re "eqinisi=lëviza, eca, u nisa". Por këtu ka diçka më të vjetër se greqishtja e re "eqinisa"; është vetë fjala "nisetë" që dokumentohet si fjalë paragreke dhe që perkthehet në greqisht si fjalë e huaj: **νείσεται· εἰσέρχεται** : origjinali "nisetë" perkthehet në greqisht si fjalë e huaj = "iserqete=vjenë". Pra gjuha shqipe shpëton origjinalin paragrek dhe greqishtja e përkthen këtë origjinal si gjuhë e huaj.

Fjalën “mjerë” Meyer e sjell si huazim nga greqishtja e re “melani=bojë e zezë” duke shpjeguar se nga e “e zeza, i ziu” del “e mjera, i mjeri”. Por fjala “amjera” shfaqet tek fjalori i Hesychit si fjalë paragreke dhe përkthehet në greqisht si fjalë e huaj: ἀμιέρα· ἀμμώδη. ἔρημα origjinali “amiera” në greqisht përkthehet si “amodhi, erima=rërë, shkretëtirë”. Ndërsa shqipja “e mjera, e shkreta, shkretëtira” shpëton origjinalin paragreke “amiera”.

Fjalën “gra, grua” Meyer e do si “fjalë të errët” por që mund të ket lidhje me indishten “gna”apo me një Hyj Irlandez “mna”, apo me italishten “accia grani” që do të thotë “dhomë haremi grash”. Edhe përse përdor referenca nga Hesychii sërisht Meyerit “nuk i bie ndërmënd” se kjo fjalë shpëtohet orgjinalisht si fjalë paragreke=pellazge: γραός·..... [γραῦς· γυνή. graos. Hesychii e përkthen në greqisht si fjalën “gjini” që do të thotë “grua”.

Fjalën “mal” Meyer e do si fjalë indoevropiane duke e afruar atë në shqip nëpërmijet sllavishtes së vjetër kishtare “iz-moleti” që do të thotë “dal në pah, shquhem”, po kështu dhe disa afërsi të tjera që lidhen me dukurinë dhe jo orgjinalitetin si psh rumanishtja “mal” që do të thotë “breg deti ose lumi”. Por kjo fjalë shpëtohet origjinalisht vetëm nga shqipja dhe tregon atë ç’ka është mali: Μάλεοι· ὄρεοι. ”Malei” që në greqisht sipas Hesychit përkthehet në “ori= malet”.

Fjalën “mërgonj” Meyer e do të huazuar në shqip nga latinishtja “mergere” ose nga rumanishtja “merge” që ka kuptimin “shkoj”. Por fjala e shqipes ruhet e njëjtë nga gjuha paragreke si fjala “a mërgon” ἀμεργὸν ἐς· ἢ εἱμαρμένη. Κρῆτες dhe që në greqisht përkthehet si fjalë e huaj “imarmeni=mërgoj”

Fjalën “mëni” Meyer e do si fjalë te huazuar në shqip nga latinishtja “mania” që është e njejtë me greqishten e re. Por fjala shpëtohet si fjala e parë e Iliades dhe në origjinalitet shpëtohet nga gjuha shqipe: ὁ μήνιε ν.....· ὠργίζετο “o mënie” e cila përkthet në greqisht si fjalë e huaj “orgjizeto=zemërohet”. Pra shqipja shpëton origjinalin dhe s ka lidhje me fjalën “mania” që nuk do të thotë patjetër “zemërim e mëri” por shkon me shumë drejt “ agresivitetit”.

Mund të paraqes një numër më të madh fjalësh në të njëjtën vazhdimësi por duke mos dashur të bëhem ripërsëritës po ja lë leximit tuaj në vazhdim si dhe krahësimeve që ju mund të bëni vetë midis Meyerit dhe këtij punimi.

Në lidhje me punën e G Meyerit dhe minimin që ai i bëri gjuhësis shqipe në arenen e gjuhësisë evropiane, unë po sjellë në radhë të parë një të dhënë nga Eqerem Çabej, ”Studime etimologjike në fushën e shqipes I”, Tirane 1982 f 35, ku ai përmend Schuchardin të ketë thënë:

“Kur njëher ti jetë caktuar shqipes një vend i ngulët e i paluajtur brënda indoevropianishtes, atëher mjaft fjalë që ne sot i marim, dhe me plot të drejtë si huazime, ka te ngjarë që do na duhet tja kthejmë prap asaj, si pronë të saj te trashëguar”.

Kjo lloj tallje nuk mundë te quhet shkencë “egzakte” por qellim i dyshimët, pasi përdoret në kohët kur varej fati i se ardhmes sone. Kaluan mbi 130 vjet që shqipfolësve në rajon ju mësohet se “jane ardhacakër edhe duhet të ulin kokën e të asimilohen”.

Si përfundim është më se e qartë se vepra e Gustav Meyerit nuk qëndron as në njohjen e fjalëve të trungut të gjuhës shqipe dhe as në shkencën krahësimtare pasi në rastin e parë ai grumbullon fjalë dialektore ndër arvanitët, arbëreshët etj, fjalë që përdoreshin për lehtësi si huazime nga gjuhët e vendeve ku jetonin shqipfolësit, por që në të vërtet nuk kanë asnjë lidhje me trungun e shqipes. Në rastin e dytë, që solla më sipër, del se Meyer nuk i përmbahet shkencës krahësimtare por i bën bisht asaj duke mos përmendur lashtësinë e fjalëve të shqipes dhe duke i sjellë këto fjalë nëpërmjet paralelizmave të gjuhëve fqinje për të aritur në

përfundimet se ne flasim një gjuhë të sajuar me fjalët e fqinjëve. Por kur ishte me se e njohur ne qarqet e shkences krahësimtare se me bazë shtyllat krahësuese të vetë kryes së kësaj dije, Franc Bopit dhe vazhduesve të tij, se shqipja përbën një gjuhë të lashtë. Si dhe, kur ai njeh fort mirë punimin e Demetrio Camardas dhe sërisht arin në këto përfundime, atëherë del më se i qartë se qëllimi tij ishte "dashuria serbe për gjuhën shqipe" dhe kjo duket që në çastin që ai ja kushton fjalorin e tij serbokrotatit Miklosiçh.

MBISHKRIMET E LASHTA

Eshtë më se e qartë se për lashtësinë e gjuhës shqipe nuk folën vetëm themeluesit e shkencës indoevropiane, si Franc Bopp e nxënësit e tij që e vendosën si njërën nga gjuhët më të vjetra, por janë dhe punime të tjera mbi mbishkrimet që nuk janë shkruajtur në gjuhët grekolatine. Që nga Otto Blau tek Iakovos Thomopulos, Nermin Vlora e Zaharia Manjani, Niko Stillos e Petrit Laze kemi një mori mbishkrimesh të lashta të lexuara me anë të gjuhës shqipe. Me mbishkrimet e lashta u mora në punimin e 2009, "Shqipja Pellazge", ndaj kam njohuri të drejtpërdrejta për gjithçka që ka lidhje me mbishkrimet në pellgun pellazgjik dhe përpjekjet që janë bërë për deshifrimin e tyre. Në truallin evropian nga mbishkrimet e linear A 1800-1450 p e s, e deri tek mbishkrimet etruske, eteokretane, arkadhoqipriote etj janë mbishkrime që mbeten si të panjohura. Në radhë të parë mbishkrimi i parë gjuhësor, Lineari A, mbetet ende i padeshifruar dhe përse ka ngjajshmëri të mëdha në alfabetin rrokor të Linearit B. Në vazhdimësi as Lineari B nuk u vërtetua të jetë gjuhë greke, gjithashtu mbishkrimet arkadhoqipriote, eteokretane, mbishkrimi i Limnos etj, vijnë deri në shek 2 p e s dhe janë shkruajtur në gjuhë të panjohura. Ja ç'thonë dietarët grekë sot:

*"**Lineari A, kryesisht nga periudha e pallateve të reja është mbishkrimi më i vjetër. U përdor gjatë periudhës 1800-1450 p e s që të shkruante gjuhën autoktonve paragreke… ! Përshtatje të Linearit A përbën shkrimi Qiprominoik që u perdor gjatë shek 16-11 p e s ne Qipro për të shprehur gjuhë paragreke….! Mbishkrimet eteokretane, emërohen kështu nga emëri i Eteokretanve (eteos:origjinal, vendas) që na i jep Homeri (t 176) për një rracë të ishullit, janë gjendur në Dhriro dhe Preso, ato datohen nga 7 p e s e deri në shek 2 p e s . Këto mbishkrime mbeten të panjohura. E njëjta gjë është dhe me mbishkrimin e shek 6, Limno"*[39]

Pra jo vetëm që "nuk paskan humbur autoktonët në mijëvjëçarin e II p e s por paskan lënë gjurmë mbishkrimore deri vonë në shek 2 p e s", dhe kjo është më se e qartë për të gjithë ata që ditën të lexonin antikitetin. Pretendohet se Lineari B 1450-1100 p e s që është vazhdimësia e Linearit A është shkruajtur në gjuhën greke, por deri më sot ende nuk janë lidhur dy fjalë bashkë megjithë përpjekjet e "Kozma Etolianit" të ditëve tona, Jorgo Babinjotit (fondacioni i të cilit përhap elenizmin në Ballkan, ashtu si në kulturën shqiptare, me paratë e lypura në Evropë) i cili pasi bën shkencë kozmaetoliane me: "ne se" u, e, g" do ti bënim "a, b, c", atëher do kishim abc", arrin në përfundimet se Lineari B është gjuhë greke. Pra as Lineari B nuk na ka dhënë dy fjalë bashkë përveç emrave vendore që janë të gjithëpranuara se i përkasin gjuhës paragreke :

"Përfundimisht kur na duhet të rindertojmë se ç'mund të ishte gjuha greke e mijvjëcarit të dytë, nuk janë të besueshme përfundimet që nxjerim nga krahësimi me dielektet e mijëvjecarit të parë"[40]

Michael Ventri mbahet si deshifruesi i Linearit B, por perveç fjalorit "ai nuk ariti të lexojë asnjë fjalë të vetme greke në linearin b" na thotë John T Hooker, Linear B an itroduction, 1980, Bristol press (përkthimi në greqisht f 70). Pra nuk kemi të dhëna për një gjuhë greke nga mijëvjeçari i dytë para erës sonë dhe gjasat tregojnë vazhdimësinë e një gjuhe autoktonve paragreke, dhe kështu vijmë në mijëvjeçarin e parë për tu ndeshur me mbishkrimet e pastra greke vetëm në epokën e helenizmit. Me këtë çështje do meremi më poshtë, por këtu do

ndalemi në mbishkrimet e mijëvjeçarit të parë në të gjithë territorin ku kemi të dhëna për pellazgët në mënyrë që t'iu japim një ide nga çka mbështetur Thomopulo 1912 për gjuhën paragrekëve =pellazgëve, duke dashur të pastrojmë njëherë e mirë "pseudonacionalizmat" në radhët e diturisë shqiptare, që nën slloganin "mëma e shqipes" kërkojnë të na kërcënojnë se po flasim për një gjuhë të krijuar gjetkë e të sjellë në Shqipëri. Për ta bërë më të lehtë kuptimin nuk po meremi me dëshifrimin e plotë të mbishkrimeve por vetëm me fjalët e pastra, dhe të ndara, shqipe që dallohen në to. Po e fillojmë me mbishkrimin e Limnos [41, 42] që dhe akademiku ynë Shaban Demiraj e pranon si mbishkrim pellazgjik.

Për ta bërë më të qartë atë që po themi, po ju lemë vetëm tre fjalët e pastra: fjalët "MARAS MAF SIAL. Këto tre fjalë të pastra tregojnë gjuhën shqipe, në një kohë që e para dhe e treta dokumentohen si mbetje origjinale të gjuhës paragreke. Mos vallë "mëma e gjuhës shqipe vjen nga Limno?". Absolutisht që jo, pasi fjalë të tilla shqipe ka dhe në mbishkrimet etruske si psh mbishkrimi i Kortones[43], ku aty pranë në Thuriu u shuajt Herodoti mes pellazgëve te Thuriu:



PESHK SHPANT TE NJOHUR…… LART VELARA AULESA. Mos vallë mëma e gjuhës shqipe vjen nga Etruria? Absolutisht jo, pasi fjalë të shqipes shpëtojnë dhe dygjuhëshit likogreke! Po shkëpusim disa fjalë nga një mbishkrim mbi varrë, në të cilin është bërë "data=përkujtimoria e gjëmës, e vdekjes [44] :

Λυκικὸν κείμενον		Ἀνάγνωσις Αὐστριακὴ	Ἀλβανικὴ παράφρασις		Ἑλληνικὴ μετάφρασις	Ἑλληνικὸν κείμενον
↑		ε	←		Ἑ	ΤΟΥΤΟ
BΨΞNΨ		bε͂νvε͂	beν͂e		πόεον	ΕΡΓΑΣΑΝΤΟ
ΞTΡTΨ		ν͂τατᾶ	ντατ' (βάριν)		ἔντος(τὸ ἄγγος)	(ΤΟ) ΜΝΗΜΑ
M↑		με	με (περ)		ἀμφὶ	
N↑	b	νε	ν<	πρίν͂ντε	νῶιν (νωϊτέροις)	
ΓΡΞNΡFΨTЖ		πρν͂ναβᾶτε͂	πριν͂νατε	τ' ἐνε	πραώταις	
ΓΟΛ↑NΙΔΡ		Πϑλ< νιδα	Πϑλ< νίδα		Ἀπολλωνίδης	ΑΠΟΛΛΩΝΙΔΗΣ

Në anën like përdoren fjalët e shqipes “E BËN DATA ME NE PRINAFATE, APOLLONI…. ”. Sigurisht që këtu kemi diçka më tepër! Ështe vetë përkthimi në greqisht që thotë: “KËTË PËRKUJTIMORE E BËNË….” Mos vallë mëma e shqipes vjen nga Likia? Absolutisht jo, pasi dhe nga Karia kemi mbishkrime dy gjuhësh karoegjyptian që në anën kariane thotë se: “HYINI HAR ION HEP IL………

[45] Mos vallë mëma e shqipes vjen nga Karia? Absolutisht jo, pasi dhe në Kretë kemi mbishkrimin shqip “ SI NGJAL MITKËN (si e ngjalli miken)…”

[46]

Këto janë disa të dhëna nga fjalët shqipe në mbishkrimet që vijnë nga shtresat paragreke dhe që i përkasin mijëvjecarit të I p es. Por për këto vënde ku janë mbishkruajtur këto mbishkrime antikiteti na ka thënë se i banonin Pellazgët. Këta të fundit sipas Homerit dhe Herodotit kishin kryeqendër me të hershme Dodonën=shqiptarët autoktonë në trojet e tyre. Dua të shtoj këtu edhe vërtetësinë e pikës së katërt të përfundimeve të Hahnit.

Por a vërtetohet të jenë shkruajtur mbishkrime shqipe në Iliri? Sigurisht që po, por në Shqipëri kemi një problem tepër të madh me organizmin e diturisë shqiptare. Gjurmë simbolesh të vjetra gjënden në malin e Dajtit, rëndom në gjirin e Gramës dhe jo vetëm. Nga Apollonia kemi mbishkrimin e famshëm “FIMIA HIJNËRON.”[47] që mjerisht Faik Drini me “Epirin, e bashkautorëve të tij, 4 mijë vjeçar grek” mundohet ta grekëzojë dhe përse në se do kishim emër grek ai do ishte “O Fimios ose O Simios”. Fjala e dytë nuk ka asnjë shanc të jetë fjalë greke pasi nuk gjendet asgjëkundi në të folurën e në fjalorët e vjetër grekë me këtë formë.

Nga tetë radhëshi i Dimalit, në një mbishkrim të përzierë ilirogrek kemi: “ERMANDAN IJEROSE… LEVRON LIND…”[48]. Por vallë si nuk i ka vënë re epigrafia shqiptare këto? Në radhë të parë epigrafia shqiptare nuk ka njerëz të specializuar që të njohin mbishkrimet e vjetra. Prova e madhe për këtë është shëmtia që i është bërë sot [49] simbolit “da” të linearit B që gjendet mbi vulën e Dimalit[50, 51] me drejtimin djathtas majtas, si edhe vetë e njëjta vulë me drejtim “majtas-djathtas” e botuar po aty në “Tabelën e Monogrameve”.

E dyta; është më se njohur tashmë se në muzeun e Apollonisë janë ekspozuar gjendje arkeologjike nga kodra e Kryegjatës përballë Apollonisë në lindje te Akropolit dhe që datojnë nga epoka e bronxit. Tani…si ka mundësi që pranë Apollonisë paska gjurmë e varre tomulare nga epoka e bronxit dhe në 100 vjet arkeologjia në Apolloni gërmon vetëm varret grekoromake?! Perse nuk studiohet vazhdimësia Pellazgo-Ilire nga bronxi tek hekuri!?

E treta: ka dhe në Apolloni mbishkrime që dokumentohen se janë shkruajtur në një gjuhë të panjohur[52] por mbi të gjitha ne Gjirin e Gramës kemi mbishkrime që shkenca jonë i quan të pa njohura.

Mbishkrimet e vjetra dhe të dhënat e antikitetit tregojnë atë çka ka për bazë shkenca indoevropiane: një pellg ku flitej e njëjta gjuhë, pellgun pellazgjik që kishte si kryeqendër më të herëshme Dodonën në Tomorr. Në Tomorr janë gjendur dhe mbishkrime ieroglife[53] . Aty ku gjëndet dhe qyteza gjigande me gjurmë gurësh gjigandë të gdhendur dhe me mbrojte natyrale. Aty ku qeramika e herët gjendet rëndomë në një zonë shumë të madhe. Aty ku njihet rëndomë "Shpella e të mirëve" e hedhur qëllimisht në erë dinamit. Aty ku është vërtetuar qytetërimi i mezolitit në Vlushë. Aty ku, dhe pa u gërmuar, të gjitha të dhënat historike të kujtojë të vertetuarën historikisht se "mëma Athinë" ishte veç një fshat i humbur para "kolonive bija" që u gjunjëzuan para saj.

GREQISHTJA E VJETËR

Cila është ajo dhe cila eshte greqishtja e re? Si erdhi në ditët tona? Në radhë të parë pranohet se grekët erdhën në Greqi dhe aty gjetën Pellazgët***:"Grekët, me një fjalë, ndeshën në Greqi Pellazgët ose Etruskët të cilët vetëm me veçantira mbijetuan në periferi më vonë"*** [54]

"Grekët e lashtë e njihnin shumë mirë se vendin e tyre e kishin mbajtur më parë popuj të vjetër që flisnin gjuhët e tyre. Pellazgët Carët, Leilegët, Finikët…" [55]

Thukidid thotë se "grekët e parë janë një togë ushtarësh të Akilit që vinin nga Efira pranë Lumit Sellienda. Por-shton ai-në luftën e Trojës nuk egzistonin grekët si gjithë pjesmarësit e luftës së Trojës, atëherë shumica ishin Pellazgët. Pra as në luftën e Trojës nuk egzistonin grekët:[56]

Την αδυναμίαν, άλλωστε, των παλαιών καιρών μου φαίνεται ότι αποδεικνύει και το γεγονός προ πάντων ότι πριν από τα Τρωικά τίποτε δεν επεχείρησεν από κοινού η Ελλάς. Νομίζω μάλιστα ότι το όνομα αυτό ούτε είχε δοθή ακόμη εις όλην την χώραν, ούτε καν υπήρχε προ του Έλληνος, υιού του Δευκαλίωνος, αλλά τα διάφορα φύλα, και εις μεγαλυτέραν έκτασιν το Πελασγικόν, έδιδαν το όνομά των εις τα υπ' αυτών κατοικούμενα διαμερίσματα. Την καλυτέραν απόδειξιν παρέχει ο Όμηρος. Διότι, μολονότι έζησε πολύ ύστερον και από τα Τρωικά, πουθενά δεν ωνόμασε με το όνομα αυτό όλους, ούτε άλλους εκτός εκείνων που ηκολούθησαν τον Αχιλλέα από την Φθιώτιδα, οι οποίοι ήσαν και οι πρώτοι Έλληνες, αλλ' αποκαλεί αυτούς εις τα ποιήματά του γενικώς Δαναούς και Αργείους και Αχαιούς

"Pamundësinë, e kohëve të vjetra, më duket se vërteton mbi të gjitha dhe e vërteta se para luftës së Trojës asgjë nuk ndërmori së bashku Greqia. Mendoj se në të vërtetë as ky emër nuk është dhënë për të gjithë vendin dhe as që ekzistonte para Elinos djalit të Dhefkalionit, por fiset e ndryeshme, në shtrirjen më të madhe PELLAZGËT, emëroheshin sipas emrave të vëndbanimeve. Provën më të mirë e ka Homeri. Sepse, dhe përse jetoi shumë më vonë se Luftrat e Trojës, ASKUND nuk emëroj më këtë emër të gjithë, përveç atyre që erdhën me Akilin nga Fthiotidha, të cilët ishin dhe Grekët e parë, por i quan ata në poemat e tij përgjithësisht, Danaus, Argjeus, Akej"

Kjo e dhënë e Thukididit përshtatet plotësisht me historinë e gjuhës greke pasi deri më këtu ne nuk kemi asnjë dokument të vetëm për egzistencën e grekëve në mijëvjecarin e dytë p e s, përveç fantazisë ëndërimtare me "greke alien". Ja ç na thonë vetë akademikët e sotëm grekë për grekët dhe gjuhën e tyre:

"Te vetmet përfundime të sigurta që mund të nxjeri kush, nga te dhëna gjuhësore të këtij tipi (emrave vendore) janë këto: të paktën një gjuhë flitej në Greqi më parë se të vinin

Grekët . Gjuha greke lindi nga SHARTIMI i një bisku indoevropian mbi një trung jo grek" [57]

Pra deri këtu kemi të dhëna se Grekët e parë quhen ushtarët e Akilit që erdhën nga një fshat me emërin Efira pranë lumit Sellienda në Fthiotidha, ndërsa gjuhësia akademike greke plotëson se, gjuha e tyre është një shartim indoevropian mbi trungun e gjuhës vëndase. Përrallat më grekër në luftën e Trojës mund të vazhdohen të studiohen nga përrallologët, por atëherë më të shumtit ishin Pellazgët dhe Grekët me gratë e bukura vinin nga një fshat, që sigurisht është e pamundur, për momentin, të njohim se nga erdhën e u vendosën aty mes autoktonëve. Ajo që njohim me siguri është se "sa më shumë i afrohemi mijëvjeçarit të parë aq më shumë shuhen ëndërrat me Pellazgë që humbën që në fillim të mijëvjecarit të dytë. Po kaq shumë rritet dhe mundësia që ata të ishin bashkohorë të epokës së antiktitetit, dhe përse Thukididi dhe Herodoti thonë se i njohën nga afër pellazgët, i pari në Atho, Malin e Shenjtë [58] dhe i dyti ne Dodonë [59]. Kjo me fjalë të tjera do te thotë se po kaq shumë rriten mundësitë që të kenë shpëtuar fjalë të tyre në greqishten e vjetër si gjuhën që shpëtoi veprat e tyre.

Tani vijmë me pranë, në kohën e Pisistratit kur u shkruajtën për herë të parë veprat e Homerit. Pranohet nga e gjithë gjuhësia se këto vepra nuk u shkruajtën të paktën në gjuhë greke por në një gjuhë te panjohur dhe më vonë brez pas brezi u përshtatën në formën që njohim si greqishtja e vjetër:

"Gjuha epike e Homerit është stacioni i fundit i nje zhvillimi të gjatë. Kjo dallohet-siç theme- ne se i zhveshim mbulesën e hollë që la lartë saj dorshkrimi brez pas brezi . Është kryesisht gjuhe Jonike por përmban edhe forma Eole, teknike edhe arkaike" [60]

"Por le të kthehemi tek gjuha Jonë dhe më parë se kudo tek Herodoti. Fjalëshkruajtesit para tij përdorën ato tema për të cilat fola dhe shkruanin në Jonisht me disa grimca epike. Herodoti ishte vazhdimëtari i tyre" [61]

"Herodoti shkruan në dialektin Jonik por më shumë të dhëna poetike, kryesisht homerike" [62]

*"**Duhet të shtrohet mendimi se te paktën deri në luftrat Persike, këta shkruajtës përdornin Joniken pa tipe Atike…."***[63] Siç vrejmë nga të dhënat e mësipërme del se Athina nuk fliste gjuhë greke, te mos flasim pastaj për periferinë që sot quhet cmendurisht gjithë greke. Gjuha që dokumentohet në Athinë është Jonikja: Por vallë cila është Jonikja? Vatra e Jonisë është Mileti, apo Miratija e Linear B. Gjuha e tyre dokumentohet e panjohur akoma, alfabeti i tyre është thuajse i njëjti me alfabetin Etrusk, alfabetin e Limnos, Eteokretanin ose me një fjalë alfabetin gjithë pellazgjik të kohës, gjurmë të cilit ka rëndomë më vjetër në Gjirin e Gramës në Vlorë. Siç vërtetuam më lartë me anë të mbishkrimeve se pellgu pellazgjik dokumentohet të flasi të njëjtën gjuhë, po kështu i mbahemi po atij qëndrimi, duke theksuar ndikimin gjithë pellazgjik të Jonëve, teje të zhvilluar, në Athinë . Jo vetëm që mbishkrimet e shkruajtura më këtë alfabet, që më 403 p e s [64] do ta adoptonin dhe grekët, por dhe gjuha Jone mbetet ende e panjohur për mënyrën se si flitej.

"Athinasit dhe te huajt që banonin në Athinë, saktë me propozim të këtyre të fundit, ndaluan nga një kohë e caktuar dhe më vonë të shkruajnë Joniken dhe filluan të shkruajnë Atiken" [65]

"Vertetësisht është një problem lidhja e gjuhës së folur Jone dhe shkrimit pezik Jonik. Fillimisht të parën thuajse nuk e njohim…." [66]

Më 427 p e s vjen në Athinë Gorjas nga Leondinet e Siçilisë dhe krijon shkrimin pezik atikas i cili do bëhet dhe baza e gjuhës greke për dy shekujt që pasojnë.

"Perfundimisht përsoset krijimi i një shkrimi pezik të jonishtes, por rreshqitja e gjuhës së pastër Jone drejtë atikes së Jonizuar është më se e sigurtë. Hapin e fundit e bëri Gorjas me krijimin e një gjuhe Atike" [67]

Me ndërtimin e gjuhës Atike fillon të shfaqet fundi i Jonikes së panjohur. Është pikerisht koha që Athina dominon në arenën politike e ushtarake me anë të Aleancës së Athinës:

*"**Pas përfundimit të luftrave me Midët, udhëheqien politikoshpirtërore e mori Athina. Rreziku Pers i bashkonte grekët dhe ky bashkim favorizonte dialektin Atik. Aleanca e Athinës me qendër faltoren e Apolonit në Dilo e bënë detyrimisht Athinën qendrën e takimeve të shumë qyteteve dhe ishujve. Këtu mblidheshin dijetarë të shumë degëve. Që të bashkoheshin, ardhësit në qytetërimin pretendues Athinas, detyroheshin të adoptonin mënyrën e jetesës Athinase mbi të gjitha të përdornin me lehtësi dialektin e zgjedhur Atik. Qytetërimi i Athinës është tashmë "pritanio e diturisë" ose "shkolla e grekëve". As lufta e pafat e Peloponezit, as therjet civile, as ngritja e forcës maqedonase nuk e ndërpreu zhvillimin e atikishtes si organ gjuhësor të gjithë grekëve. Përkundrazi Filipi II e vendosi atikishten si gjuhën e parë të shkollimit e të organizimit të shtetit të tij. Aleksandri dhe pasardhësit e aristokratëve të familjeve maqedonase ishin shkolluar në gjuhën atike. Sulmi i shkëlqyeshëm gjithë grek në lindje përhapi elenizmin deri në Baktriani. Në qytetet shumë kombëshe merr jetë thënia e famëshme e Isokratit se "Grekët janë ata që marin pjesë në shkollimin grek". Dhe shkollim para së gjithash do të thoshte të mësoje gjuhën greke"*** [68]

Kjo është situata në Greqi, kjo është greqishtja e njohur që u krijua teknikisht e u përhap me anë të shkollimit. Këtë gjuhë e njihnin vetëm ata që shkolloheshin. Shkollimi ishte vetëm për aristokracinë, ndërsa për popullin kjo gjuhë ishte e panjohur, pasi mësohej në letër e nuk mbinte në buzet e tij. Kështu paralelisht më gjuhën e popullit, kemi dhe gjuhën atike=greqishten teknikoletrare. Të dyja gjuhët mbijetuan 2000 vjet bashkë duke dhenë e marë nga njera tjetra, por më së fundi me bekimin e autokratorisë bavariane mbizotëroi gjuha teknikoletrare, atikishtja. Kjo gjuhë u mor nga kisha në shek II e s, e cila e shpëtoi duke e ruajtur për gati 2000 vjet me radhë jo si gjuhën e popullit: ***"Atikun e ashpër e pranoi më së fundi si gjuhë të parë dhe kisha e krishterë…. Çmimi i kthimit mbase ishte shumë i rëndë. Këmbëngulia e atikistëve në të shkuarën e lavdishme si dhe kundërshtimi i prerë që të pranojnë të vetëvertetuarën se gjuha shëndrrohet e cojë vëndin në dygjuhësi e cila e mundoi kombin për 2000 vjet dhe do të thellonte hendekun midis pakicës së të shkolluarve dhe popullit të thjeshtë. Hyrja në pasurinë e shkollimit kërkonte një punë shumëvjeçare me një organ gjuhësor që nuk mbinte në buzët e popullit por mësohej në letër. Vlerësimi i padrejtë i nje vepre me kriterin e vetëm gjuhën në të cilën ishte shkruajtur bëri që të lihen mënjanë shkruajtësit që shkruanin në gjuhën e thjeshtë. Përfundimi i trishtueshëm i këtij mendimi të prapambetur coi në humbjen e shumë veprave shkencore"***[69]

Duke përmbledhur më së fundi se cila ishte greqishtja e vjetër arijmë në përfundimin se greqishtja e vjetër me atikishten janë dy gjuhë të ndryeshme. Atikishtja u krijua si gjuhë letrare, nën mburojen e Aleancës së Athinës, e cila mësohej vetëm në shkollë që nuk mbinte në buzët e popullit. Atikishtja doli jashtë mureve të Athinës pas humbjeve nga Sparta dhe Maqedonia . Aleksandri i Madh e shëndrrojë në gjuhë te gjithë pushtimeve të tij, duke i dhënë përhapjen më të madhe kësaj gjuhe. Paralelisht me atikishten kemi gjuhën e folur të popullit e cila vjen nga e shkuara, e cila është e ndryeshme nga atikishtja

Përpara nesh kemi një gjuhë greke që quhet „atikishtja", e cila formohet teknikisht dhe përhapet vetëm mes atyre që shkolloheshin në këtë gjuhë, paralelisht kemi një vazhdimësi të një gjuhe të panjohur me të cilën ishin shkruajtur veprat e Homerit dhe më pas të Herodotit etje.

E para nuk u perhap gjërësisht kurrë në popull, por u ruajt me zell si gjuha e oborreve mbretërore, gjuha e tregtisë, gjuha e të shkolluarve. Kjo gjuhë humbi gati për 2000 vjet me radhë pasi nuk u bë kurrë gjuha e popullit deri pas viteve 1800 kur fillojë ndikimi formal i një kombi dhe e riktheu gjuhën 2300 vjet më pas, falë ruajtjes së saj nga kisha.

Pra atikishtja teknike dhe greqishtja e sotme janë e njëjta gjuhë. Ndërsa greqishtja e vjetër dhe pse është atikizuar sërisht është një gjuhë e huaj për gjuhën greke, e cila në pergjithësi përkthehet dhe nuk shpjegohet në greqishten e re. Quajmë greqishte të re gjuhën e mbishkrimeve të pastra të epokës së helenizmit, atikishten teknike, dhe atë që flasin sot grekët.

Ndërsa greqishtja e vjetër e shpëtuar më ane të dorë rishkrimeve duket të vijë nga larg dhe me kalimin e kohëve, llogjikisht duke u turbulluar nga ndikimi i atikizmit, pranon në gjirin e saj një ndikim të madh fjalësh të gjuhës atikase: Kjo është "greqishtja e vjetër„ e cila sigurisht që nuk përbën gjuhën e ndonjë kombi me formën me të cilën ne e njohim sot. Quajmë greqishte të vjetër atë gjuhë me të cilën janë dokumentuar dorërishkrimet brez pas brezi. Kjo gjuhë shpëton fjalë paragreke të antikitetit ndaj në shumicën dërrmuese të saj veç përkthehet në greqishten e re. Cdo te thotë kjo? Kjo do te thotë, vec të tjerash, se kjo gjuhë shpëton fjalë nga gjuha që u dokumentua Homeri në orgjinalitet. Tregon fjalë të veprës së parë evropiane që dijetarët e sotëm e duan të jetë shkruajtur në një gjuhë të panjohur. Tregon mes te tjerash cakun e kapërcimit nga paragreqishtja tek greqishtja, ndaj gjasat që kjo gjuhë të shpëtoj fjalë paragreke janë shumë të mëdha dhe përse me kalimin e kohës u atikizua jashtë mase.

Ritheksoi se „greqishtja e vjetër me formën që shpëtohet nuk ka qënë kurrë gjuhë e një shteti. Kjo forëm e greqishtes së vjetër është një përshtatje fonologjike e fjalëve paragreke në gjuhën teknike atiken=greqishten është një ndërthurie mindis fjalëve paragreke edhe greqishtes së re, atikishtes". Vetë fakti që u shpëtua me anë të dorshkrimeve brezë pas brezi tregon atikizimin e pjesshem të saj por jo në shkallen që të quhet gjuhë greke.

MBETJET ORIGJINALE TË GJUHËS PARAGREKE

Hymë keshtu në çështjen kryesore të këtij punimi. Duke e nisur nga shkenca e krahësimit të fjalëve vërejtëm se egzistonte diku një pellgë në të cilin është folur mëma e gjuhëve. Ky pellgë në shtepinë tonë evropiane vërtetohet të jetë pellgu pellazgjik që si kryeqendër më të herëshme tregohet të kishte Dodonën në malin e Tomorrit. Rrjedha e jetës së fjalëve të përbashkëta në gjuhët evropiane vërtetohet si historikisht dhe gjuhësisht të jetë e tillë:Pellazgët-Grekët-Latinët dhe nga këto tre grupe vijnë fjalët e përbashkëta në gjuhët evropiane. Mbishkrimet pellazgjike, pjesëza të së cilave solla më sipër, janë treguesi i parë i ketij pellgu. Treguesi i dytë ka të bejë me mbetjet origjinale të gjuhës paragreke me të cilat do të meremi në vazhdim. Por që të ishte më e qartë kjo, mu desh t ju përgjigjesha me radhë pyetjeve se "Cila është gjuha shqipe sipas grupmendimeve të ndryeshme? Cilat dokumente mbishkrimore vërtetojnë shqipen si gjuhën e paragrekëve? Si dokumentohet kalimi nga paragreqishtja tek greqishtja? A është greqishtja një gjuhë unike që nga mijvjëçari i dytë para erës sonë apo është një gjuhë teknike e krijuar në letër në shek 5-4 p e s dhe e përhapur me anë të shkollimit?

Në se greqishtja është gjuhë teknike e krijuar në letër atëher sigurisht që do kenë shpëtuar mbetje origjinale të gjuhës së paragrekëve dhe si rrjedhojë ato mundë të na cojnë nga poshtë lartë tek gjuha e pellazgëve. Kemi të dhëna nga antikiteti se "mbretërit në Iliri[70] drejtonin me bazë Altarin e Perëndive në kohën e Herodotit, që siç pamë më lartë nuk dokumentohet të shkruhej një gjuhë greke, por që fatkeqsisht ne nuk i kemi zbuluar ende qytetet tona ilire që të na japin kënaqsinë e gjuhës shqipe pasi "jemi ca te zënë arkeologjikisht këto 100 vjet me varret e kolonëve".

Më lart pamë se atikishtja që u bë gjuha e shkollimit të grekëve, në një kohë që egzistonte një gjuhë paralele më të, gjuha e popullit, e cila nuk ishte e njëgjajshme me atikishten. Kjo do të thotë se paralelisht me gjuhën e krijuar ne shek 5-4 p e s egzistoi një gjuhë e folur nga populli e cila nuk u dorëzua kurre tek atikishtja deri në epokën moderne të radios, ushtris, e

gjithë shkollimit të detyruar. Sigurisht që duke ecur njëkohësisht të dyja gjuhët do mernin nga njera tjetra…. deri sa me 1804 Adhamantios Korais të propozonte rrugëzgjidhje për regullimin e kësaj situate.

Fjalët e vjetra patën fatin e mirë të dokumentoheshin në epokën e helenike të antikitetit të vonë nga njerëz që njihnin fjalën e vjetër e kuptimin e saj në greqisht. Por dhe veprat e dorëshkruajtura brez pas brezi ruajtën e ruajnë fjalë të huaja për gjuhën greke. Vetë "mirë mëngjesi" i Iliadës ruhet si fjala "minin, mënin" dhe përkthehet në greqishte "thimo=zemërimin". Pra nga Homeri kanë shpëtuar qindra fjalë por dhe fjala e parë e veprës së tij "mëria" e cila është e huaj për gjuhën greke dhe e njejtë me gjuhën shqipe. Por ler te shkojm tek gjuha e Pellazgeve me fjalet e Eqerem Çabejit:

''Nje interes të veçantë për gjuhësin shqiptare paraqet çështja a ka ndonjë lidhje midis gjuhëve ose gjuhës së substrakteve paragreke të Greqisë së vjetër dhe gjuhës shqipe, ose mbeturinave të atyre substrakteve në ketë gjuhe? Ky problem lidhet me emrin e Pellazgëve edhe pellazgjishten"[71] Çabej këtu na thotë se „në se ka lidhje midis gjuhës se paragrekëve dhe shqipes, kjo lidhet me emërin e pellazgëve". Pikerisht ky është punimi im në vazhdim.

Drejtësisht vendon Shaban Demiraj se: "***Natyrisht që këto përfundime e të tjera të gjajshme për pellazgjishten duhen marë me njefarë rezerve përderisa janë nxjerë më bazën e një matriali të dokumentuar në greqisht, ku veshtirë se mund ti kenë shpëtuar njefarë përshtatje në fonologjinë e kësaj gjuhe***"[72] .

Sigurisht, parashtesat, prapashtesat dhe të tjera përshtatje fonologjike në gjuhën greke të fjalëve të pellazgjishtes janë më se të qarta. Por ka dhe nje mori fjalësh të pastra që nuk i janë përshtatur fonologjisë dhe mënyrës së dokumentimit të greqishtes. Më parë se të hyjmë në hollësira do na duhet të dimë në radhë të parë në se e pranon gjuhësia evropiane „egzistencën e fjalëve paragreke në fjalorët e lashtë të greqishtes së vjetër":

"Është[73] ***më se e vërtet se nuk është greke shumica e emërtimeve vendore të Greqisë, të ishujve si dhe bregdetit të Azisë së Vogël. Dhe as nuk është greke një pjesë e fjalorit të greqishtes i cili paraqet në disa raste të njetat çështje me emrat vendore"***

Pra ato fjalë që paraqiten si të huaja në fjalorët e greqishtes së vjetër, kanë ngjajshmëri me emrat vendore në Greqi. -te cilat pranohen se i përkasin popullsisë vëndase.

"***Që herët është vënë re se fjalori i greqishtes së vjetër përmban një numër të rëndësishëm fjalësh me prejardhje të huaj***"[74]

Siç vrejmë greqishtja e vjetër, në ndryshim nga greqishtja e re =atikishtja letrare e shek 5-4 p e s, "përmban një numër të rëndësishëm fjalësh me prejardhje të huaj". Mos vallë ketu duhej të ndalonim më parë se sa të fluturonim në Indi e në Kinë? Shkencërisht po, pasi këtu ndali Franc Bopp, August Schlecheri, August Pott dhe Stier e Camarda të cilët nuk ishin një rastësi në këtë shkencë por ishin ata që e krijuan shkencën e gjuhësisë evropiane. Dërmueshëm mbetjet origjinale të gjuhës së paragreke tregojnë gjuhën shqipe si gjuhën e paragrekëve ndaj drejtësisht venduan gjuhëtarët e mësipërm. Çuditërisht kjo rrymë nuk u perkrah nga fqinjët tanë me Miklosiçhin në krye e Meyerin pas tij! Po përse Tirana historiko gjuhësore ndoqi këta të fundit duke ju dhënë tmerrin shqipfolësve jashtë Shqiperisë dhe duke i lënë ata nën dhunën asimiluese të fqinjëve!?

Prova krahësuese midis shqipes dhe mbetjeve të gjuhës para greke!

Duke u nisur nga aritjet e shkencës krahësimtare po marim për të krahësuar një grup fjalësh nga mbetjet origjinale të gjuhës para greke në greqishten e vjetër. Ashtu sikurse e pranon e gjithë gjithësia dijetarë, se këto mbetje lidhen me gjuhën e Pellazgëve, po kështu na tha dhe Eqerem Çabej më siper. Atëherë le ti marrim në shqyrtim, me bazë fjalorin e shek VI të Hesychit Alexandrinos.

πάρος· ἔμπροσθεν. πρότερον . origjinali “paros”. greqishtja” embrosthen, protereon = para, përpara”. Origjinali “paros” është i huaj për gjuhën greke, përkthehet në këtë gjuhë si fjalë e huaj “embrosthen, proteron”, ndersa shqipja ruan origjinalin “par, para, perpara” . . Me këtë llogjikë ecim me poshtë:

λιάσαι· χωρίσαι, origjinali “liase, liashe”, në greqisht përkthehet si fjalë e huaj: “horise=e ndau, e la”, midis këtij origjinali dhe gjuhës shqipe sot kemi të njejtën fjalë“ljashe, e lije, ndaje”

νεἰσεται· εἰσέρχεται . origjinali “nisetë”, greqishtja e përkthen si fjalë të huaj: “iserqete=vjen”, ndërsa shqipja ruan origjinalin “niset”.

δίζα· αἶξ. Λάκωνες origjinali “dhiza”, greqishtja e përkthen si fjalë të huaj “eks=dhi”. shqipja ruan origjinalin “dhiza, dhi, dhia”

πρίεται σχίζεται. origjinali „priete“, në greqisht përkthehet si „sqizete= shqyhet, këputet, prihet“. shqipja ruan origjinalin „pret, prihet“

Hom. *εἶκε· ὑποχώρει . origjinali “iki”, në greqisht përkthehet si “ipohoro-iki, largohem, tërhiqem”. shqipja shpëton origjinalin “iki”

βῆ· ἔβη, ἐπορεύθη. origjinali “vi”, në greqisht përkthehet si “eporefthi= ecën, vjen”. shqipja “vi” ruan origjinalin.

ἐδανά· ἐδώδιμα, origjinali „edhana“, greqishtja e përkthen si „edhodhima = e dhëna“ shqipja „e dhana, e dhëna“ shpeton origjinalin.

ἐντρέχειν· ἐναρμόζειν origjinali “endreqin” , në greqisht përkthehet si “enarmozin=regullojnë, fiksojnë” , shqipja shpëton origjinalin “e ndreqin”

αὐς· αὐτός. Κρῆτες καὶ Λάκωνες . origjinali ”ais” , në greqisht perkthehet si “aftos=ai”, shqipja ruan origjinalin “ai”

παρδακῶν· διύγρων origjinali “pardhakon”, ne greqisht përkthehet si “dhiigron= ujëmbajtëse”, shqipja shpëton origjinalin “pardhakon, bardhaku”

γοτάν· ὑν. Μακεδόνες origjinali ‘’gotan’’. në greqisht përkthehet ‘’in-enë, gotë, pijembajtëse ‘’. Kjo fjalë është tregues i gjuhës së vjetër maqedonase, sot shqipja ruan origjinalin ‘’ gotan, gota’’.

ἀμιέρα· ἀμμώδη. ἔρημα . origjinali ‘’amiera’’, në greqisht përkthehet si “amodhi, erima=rërë, shkretëtirë”, shqipja ruan origjinalin “amiera, e mjera, e shkreta, shkretëtira’’

ἄσεπτον· ἀσεβές. origjinali “asepton”. në greqisht përkthehet si “ aseves= i parespekt ” , shqipja është më afër origjinalit “asepton, a sëmton, shëmton”

βραχέ..· ἐψόφησε origjinali “vrahe”, greqishtja e perkthen si “ epsofise =ngordhi” , shqipja ruan origjinalin “vrahe”

[*εἰδάλλεται· φαίνεται s] origjinali „idallete“, greqishtja e perkthen si „fenete, duket, shfaqet“. shqipja ruan origjinalin „ dallet, dallohet“

πλαγάν· πληγήν . origjinali ‘’ plagan’’, greqishtja e përkthen si ’’pligji = plagë’’ . shqipja shpëton origjinalin ‘’plagan, plagë, plaga’’.

σκηπήϊον· πτύον origjinali „sqipiion“, në greqisht përkthehet si „ ption=shpend“, shqipja e shpëton këtë fjalë në emërin e shqiponjës, në emërin e vendit, në emrin e gjuhës, në simbolin e flamurit.

κραῖρα· ἡ κεφαλή, origjinali “krera”, në greqisht përkthehet si “i qefali = koka”, shqipja ruan origjinalin “krera, kreu”. Është e pallogjikë që origjinali “krera” që

dokumentohet tek paragrekët të vijë në gjuhën shqipe nga një shëndrim i saj në “cereburun” e më vonë të bëhet prapë “krera”.

[γάναι· περιπτύσαι] origjinali “gjanë” , greqishtja e përkthen si “ periptise=gjanë, afërsisht”, shqipja shpëton origjinalin “gjanë, ngjanë”

ἀράσσει· συντρίβει. origjinali ‘’arashi ‘’, në greqisht përkthehet si ‘’ sindrivi = bie, përplaset ‘’, shqipja ruan origjinalin „ a rashi, rash’’

γραός·..... [γραῦς· γυνὴ origjinali “graos”. greqishtja e përkthen si “ gjini=grua ”, shqipja ruan origjinalin “gra”

ἀραχθείς· διωχθείς origjinali „arakthis“, greqishtja e përkthen si ‘’ dhiokthis=i dëbuar’’, shqipja shpëton origjinalin ‘’arakthis, arratis’’

γούνων· τῶν γονάτων origjinali ‘’gjunon’’. greqishtja e përkthen si „ton gonaton= gjunjët’’. shqipja ruan origjinalin ‘’gjunon, gjunjon, gjunjët’’

ἀσκελές· σκληρόν, χαλεπόν. origjinali ‘’askeles’’. greqishtja e përkthen si “skliron =e ashpër”, shqipja ruan origjinalin “askeles, a shkelesh, e pashkelur ”

Δέλλει· καλεῖ origjinali ‘’delli’’, greqishtja e përkthen si ‘’kali=ndiell, fton’’. shqipja ruan origjinalin ‘’delli, ndjelli ‘’

βαλ[λ]ήν· βασιλεύς. Φρυγιστί origjinali „ballin’’, greqishtja e përkthen si „vasilias= mbret“. . . por kjo fjalë pranohet se nuk i përket gjuhës greke as me këte formë „vasilias“. Fjala shpjegohet si fjalë Frigase. Qytetet Frigjisë, Plakia dhe Skilasi, i vizitoi nga afër Herodoti dhe njohu aty Pellazgët. Shqipja shpëton origjinalin „balli, kryeja, mbreti“

βαλιῶται· πρόγονοι origjinali “baliote”, greqishtja e përkthen si “progoni=para ardhësit”, shqipja shpëton origjinalin “balliote=të parët, balli ynë”

ἄσπετα· ἀπαρακολούθητα. origjinali “aspeta’’, greqishtja e përkthen si “aparakoluthita=te pakapshme”, shqipja ruan origjinalin “aspeta, a shpejt, shpejt”.

ἄσπετος· ὁ Ἀχιλλεὺς ἐν Ἠπείρῳ origjinali “aspetos”. greqishtja e përkthen si “keshtu i thonë Akilit në Epir” , Epiteti homerian i Akilit “këmbëshpejti”, shqipja shpëton origjinalin “aspetos, a shpejt, shpejt”

· δαί· σύνδεσμος . origjinali ‘’dhe’’. greqishtja e përkthen si ‘’sindhezmos=lidhës’’ , si lidhës sot kjo nuk egziston në gjuhën greke, shqipja ruan origjinalin ‘’dhe’’ si lidhëz.

[Βαρθεῖ...· γένος ἰθαγενῶν]. origjinali “Barthi”. greqishtja e përkthen si “gjenos ithagjenon”. shqipja ruan origjinalin në emërin “Bardhi” si dhe fjalën “bardhë”

***ἔντυε· παρασκεύαζε** origjinali “endie”. greqishtja e përkthen si “parasqevaze=prodhon”. shqipja ruan origjinalin “endi, endie pëlhurë”.

ἄφαρ· ταχέως. ἢ εὐθέως. origjinali “afër”. përkthehet në greqisht si “ taqeos= ne cast”, aty pranë, shqipja ruan origjinalin “afër”

ἔτας· τοὺς κατ' ἐπιγαμίαν οἰκείους. origjinali “etas”, në greqisht përkthet si “tus kat’ epigamian iqius=prindërit e ligjshëm”, shqipja shpëton origjinalin “etas=prind”, që siç vërtetohet në lashtësi nuk ka pasur rolin e gjinisë mashkullore, ashtu sikurse e duan disa sot.

καμεῖν· κοπιάσαι. origjinali “kamin”, në greqisht përkthehet si “kopjase=afrohu”, shqipja ruan origjinalin” kembin, ecin, afrohen”

βάριον· πρόβατον. origjinali “barion”, greqishtja e përkthen si “ provaton = deleve”, shqipja ruan origjinalin “bariu, bar, bari”

χάπτοντες· ἀποδεχόμενοι. origjinali “kaptondes”, në greqisht përkthehet si “apodhekom e =pranoj”, shqipja shpëton origjinalin “kap, kaptoj, kuptoj”

† κάλλης· καρπίμου origjinali “kallis”, greqishtja e përkthen si “karpimu= fryti”, shqipja shpëton origjinalin “kallis, kalliri”

εὐρώεντα (Hom. Y 65) σκοτεινά, ζοφώδη. origjinali “evroenda”, greqishtja e përkthen (Suida, nga Homeri Y 65) si “skotina=e errëta, e vrënjtura”, shqipja ruan origjinalin “evroenda, e vron, e vrënjtura”. Po keshtu Hesychii na jep fjalën “evropon” **εὐρωπόν· σκοτεινόν r.** origjinali „evropon“. greqishtja e përkthen si „skotinon=e errta“. shqipja ruan rrënjën, e vron, e vrënjtur“. Nga ngjyra e errët e Herës, që sipas mitit Zeusi e rrëmbeu në Siri, vjen dhe epiteti i Herës: **Εὐρωπία· ἡ Ἥρα** “Evropia=Hera“. Nga kjo fjalë e shqipes rrjeth emëri i Evropes

***Εὐρώπη· χώρα τῆς δύσεως ASPn. ἢ σκοτεινή** . origjinali „Evropi“. në greqisht përkthehet si „vëndi i perëndimit. e errëta, e vrënjtura“. dhe sigurisht është me se i njohur epiteti i Evropës që në shumicën e vitit është „E vron, vrënjtur“

Πιερίδες· αἱ Μοῦσαι ἐν Μακεδονίᾳ origjinali ‘’Pieridhes’’ , në greqisht përkthehet si “ kështu ju thonë Zanave në maqedonisht”, shqipja shpëton origjinalin ‘’Perri, Perria’’

Ζάν· Ζεύς S’ . origjinali. Zanë. greqishtja e përkthen si ‘’Zeus”, shqipja e ruan sot origjinalin “Zanë, Zot”.

οὖρους· φύλακας. . origjinali „urus“. greqishtja e përkthen si „filakas = roje“ shqipja ruan origjinalin „u ru, u ruan, rojtari“

κιέλλη· φέγγος, αὐγή, φῶς. origjinali “qielli”, greqishtja e përkthen si “fegos, avgji, fos =zbardhje, drite”. shqipja ruan origjinalin “qielli”.

κρουνοί· ῥεῖθρα, ὀχετοί, ὑδάτων ἐκβολαί origjinali “kruni”, greqishtja e përkthen si “rithra, oqetos, idhaton ekvole= kroi, burimi…” . përkthimi i parë “rithra” lidhet vetë me shqipen “rrjedha”, ndërsa vazhdimi tregon të njejtën fjalë që e shpeton në original shqipja, dhe pa qenë nevoja të bëhet “krana” apo “cereburun”, pra në shqip ruhet origjinali “kruni”

Μάλεοι ὄρεοι origjinali “Malei”. greqishtja e përkthen si “orii = male” , shqipja shpëton origjinalin “mali"

Siç del nga ky grup fjalësh vrejmë se gjuha shqipe duke u krahasuar me gjuhën greke, me bazë mbetjet origjinale të gjuhës së para greke, rrezulton të shpëtojë gjuhën paragreke = Pellazgjishten. Kjo do të thotë shqipja rrezulton të jetë dhe më e vjetër se vetë ajo. Si rrjedhojë bien teoritë që e duan shqipen si një gjuhë që ka huazuar fjalët e sllavëve, turqëve, grekëve e romakëve, për tu formuar. Sigurisht që nuk duhet të përzjejmë ndërhuazimet e reja midis fqinjëve me mbetjet e lashta origjinale.

© Pashtriku.org, Shkurt'2014